



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Kosova
Cumhuriyeti



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVA
KOSOVA CUMHURİYETİ
Komana e Prizrenit • Opština Prizren
Prizren Belediyesi
Kryetari i Komunës / Predsednik Opštine
Belediye Başkanı

01 Nr. 397/25 Dt. 04.07.2025



Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren
Belediyesi

Raporti i punës së Njesisë për Komunikim me Publikun për periudhën Janar-Qershor 2025

Njësia për Komunikim me Publikun, gjatë muajve janar-qershor 2025 ka ruajtur me kujdes të shtuar profesionalizmin, etikën dhe integritetin në informimin e publikut dhe zbardhjen e të gjitha dokumenteve që ka hartuar kryetari i Komunës, Kuvendi i Komunës dhe të gjitha zyrat tjera administrative.

Njoftimet, thirrjet, vendimet dhe dokumentet tjera janë lekturuar dhe përkthyer në të gjitha gjuhët zyrtare të komunës sonë (shqip, boshnjakisht, turqisht dhe romisht), brenda afateve ligjore janë publikuar në webfaqen zyrtare të komunës dhe platëformat tjera sociale.

Gjithashtu Njësia për Komunikim me Publikun ka bartur organizimin profesional e ligjor të konsultimeve publike për dokumentet e hartuara nga kryetari i komunës, kuvendi dhe të gjitha drejtoritë komunale. Po ashtu, kemi organizuar 7 takime publike me qytetarë në lokalitete të ndryshme për Buxhetim me Pjesëmarrje për vitin 2026.

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal (MAPL), Unioni Evropian, Suedia dhe Zvicra si sponzorues të grandit të performancës për komunat që kanë treguar rezultate të larta në vendimmarrje, respektimin e afateve ligjore dhe respektimin e procedurave administrative, në muajin janar të këtij viti e njoftojnë komunën e Prizrenit se është përfituese e grandit në vlerë 2 milion e 47 mijë euro.

Instituti Demokratik i Kosovës-KDI, në muajin prill ka publikuar Transparometrin për të gjitha komunat e Kosovës në fushat: transparencë dhe llogaridhënie. Komuna jonë është ranguar e para nga komunat e mëdha dhe është vlerësuar se ka përmbushur të gjithë indikatorët në lartësinë 98.96 përqind.

Njësia për Komunikim me Publikun, gjatë periudhës raportuese janar-qershor 2025, ka pranuar 75 kërkesa për qasje në dokumente publike. Të gjitha kërkesat janë shqyrtuar në afat ligjor dhe dokumentet e kërkuara u janë ofruar palëve kërkuuese.

Të dhëna për Konsultime Publike:

Publikimi i me kohë i planit për organizimin e konsultimeve publike të planifikuara që do të mbahen gjatë vitit 2025:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/01/Plani-i-konsultimeve-publike-me-qytetare-per-vitin-2025-PDF-SCAN.pdf>.

Komuna jonë ka planifikuar të mbajë 15 konsultime publike, deri në këtë periudhë të raportimit janë mbajtur:

Tabelori me emra dhe statistika për Konsultimet Publike:

Emri i Konsultimit Publik	Nr. i pjesëmarrëseve	Nr:Femra	Nr.Meshkuj
1-Rregullore për Transparencë në Komunën e Prizrenit	27	10	17
2-Strategjia për sigurinë në institucionet edukative arsimore në Komunën e Prizrenit	40	17	23
3-Rregullore Varrim dhe Mirëmbajtjen e Varrezave të Reja të Prizrenit në Landovicë	16	8	8
4-Qarkoren e Pare Buxhetore dhe KAB-in 2026/28-kryetari i Komunës, Shaqir Totaj	30	5	25
5-Qarkoren e Pare Buxhetore-2026 dhe KAB-in 2026/28-KPF	32	9	23
6- Projekt- Planin Lokal të Veprimit për Përfshirjen e Komuniteteve Rom, Ashkali dhe Egjiptian në Komunën e Prizrenit 2025-2028	27	9	18
Totali:	172	58	114

Të dhëna për Buxhetim me Pjesëmarrje:

Në afat ligjor kemi bërë publikimin e kalendarit, përfshirë të gjitha detajet për organizimin e Buxhetimit me Pjesëmarrje për vitin 2026:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/04/Kalendari-i-takimeve-publike-per-Buxhetim-me-Pjesemarrje-per-vitin-2025-Shq-Bosh-Tur.pdf> .

Sipas planifikimit paraprak kemi mbajtur 7 takime publike me qytetarë për Buxhetimin me Pjesëmarrje në 7 lokalitete urbane dhe rurale: Në fshatin Malësi e Re, lagjen “Bylbyldere”, lagjen “Ralini”, në fshatin Hoçë e Qytetit, në fshatin Mushnikovë dhe në lagjet “11 Marsi” e “2 Korriku”.

Përmes këtij procesi qytetarët në takimin e parë i kanë propozuar projektet e tyre, kurse në takimin e dytë kanë votuar për projektet e propozuara dhe projekti që ka marrë më shumë vota do të jetë pjesë e buxhetit për vitin 2026.

Tabelori për Buxhetim me Pjesëmarrje:

Emri i Buxhetimit me Pjesëmarrje	Numri i pjesëmarrëseve	Nr:Femra	Nr.Meshkuj
1-Buxhetimi me Pjesëmarrje në fshatin Malësi e Re	51	3	48
2-Buxhetimi me Pjesëmarrje në lagjen “Bylbyldere”-Prizren	148	54	94
3-Buxhetimi me Pjesëmarrje në lagjen “Ralini”-Prizren	26	3	23
4-Buxhetimi me Pjesëmarrje në fshatin Hoçë e Qytetit	24	2	22
5-Buxhetimi me Pjesëmarrje në fshatin Mushnikovë	52	1	51
6-Buxhetimi me Pjesëmarrje në fshatin Romajë	33	2	31
7-Buxhetimi me Pjesëmarrje në lagjet “11 Marsi” dhe “2 Korriku”	220	95	125
Totali:	554	Totali: 158	Totali: 390

Të dhëna për Takime Publike:

Publikimi me kohë i planit për organizimin e dy Takimeve Publike të kryetarit me qytetarë për të raportuar për punën 6 mujore si dhe raportin vjetor për vitin 2025:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/05/Plani-i-Takimeve-Publike-per-Vitin-2025-PDF-SCAN.pdf>.

Janë mbajtur **2** takim publik me qytetarë për Renovimin dhe punimi e sipërfaqeve rekreative të shtegut Marash-Kala. Takimi i parë me qytetarë i kryetarit për raportim për 6-të mujorin e vitit 2025.

Tabelori me të dhëna për Takime Publike:

Emri i Takimit Publik	Numri i pjesëmarrëseve	Nr:Femra	Nr.Meshkuj
1-Renovimi dhe punimi e sipërfaqeve rekreative të shtegut Marash-Kala	13	2	11
2-Takimi i parë me qytetarë i kryetarit për raportim për punën 6-të mujore për vitin 2025	50	18	32
Totali:	63	20	43

Të dhëna për Dëgjime Buxhetore:

Është publikuar me kohë Plani i Dëgjimeve Buxhetore për buxhetin e vitit 2026. Komuna ka planifikuar ti mbajë 9 dëgjime publike me qytetarë.:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/02/Plani-i-Dokumenteve-per-Degjime-Publike-2025-PDF-SCAN.pdf> .

Këtë vit kemi planifikuar të organizojmë 9 dëgjime publike, mbajtja e dëgjimeve nis gjatë muajit korrik 2025. Gjithashtu është hartuar edhe plani i veprimit për organizimin e dëgjimeve buxhetore dhe kalendari i dëgjimeve buxhetore.

Plani i veprimit:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Plani-i-veprimit-i-Komuna-se-Prizrenit-per-degjime-buxhetore-per-vitin-2025-PDF-SCAN-1.pdf>

Kalendari:

<https://prizren.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/06/Kalendari-i-degjimeve-buxhetore-publike-me-qytetare-per-buxhetin-e-vitit-2026-final-PDF-SCAN-1.pdf>

Ymer Berisha

Udhëheqës i Njesisë për Komunikim me Publikun

